

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Nebojsa Boriçiq, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit F. A. nga P., kundër të paditurit – Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK), për shkak të anulimit të aktit administrativ A. nr..... dt....., duke vendosur lidhur me kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.255/2016 dt.19.09.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me 25.07.2017, mori këtë

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa e paditësit F. A. për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.255/2016 të datës 19.09.2016.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.255/2016 të datës 19.09.2016, është refuzuar ankesa e paditësit F. A. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje administrative A.U.nr.1651/2013 dt. 07.06.2016 me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të paditurit Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në Prishtinë (shkurt: KPMSHCK) A.nr..... dt.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH.nr.255/2016 dt.19.09.2016, paditësi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm për shkak të shkeljes të së drejtës materiale dhe të shkeljes së dispozitave të procedurave, me propozim që të aprovohet kërkesa.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 53 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

Kërkesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr.255/2016 dt.19.09.2016 është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit F. A. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore/Dep.administrativ A.U.nr.1651/2013 dt.07.06.2016 me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të paditurit –KPMSHCK A. nr..... dt.....

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme gjen se gjykata e shkallës së dytë drejt ka vendosur kur ka refuzuar ankesën e paditësit.

Sipas nenit 59.1 dhe 2 të Ligjit nr. 03/L-149 për KPMSHCK është përcaktuar se nëpunësit civil janë të detyruar të jenë të pranishëm në vendin e punës në bazë të kushteve të emërimit të tyre dhe gjatë orarit të përcaktuar për funksionimin e institucionit punëdhënës. Nëpunësit civilë janë të detyruar ti informojnë eprorët e tyre për çdo mungesë nga vendi i punës dhe të marrin autorizim për çdo largim nga vendi i punës. Mosinformimi ose mungesa e palajmëruar nga vendi i punës konsiderohet braktisje e vendit të punës dhe dënohet me përputhje me ligjin.

Bazuar në të lartëcekura të Ligjit nr.03/L-149 për KPMSHCK paditësit i është shqiptuar masa disiplinore, ndalesë në të ardhura personale prej 10 % e pagës mujore.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, kjo gjykatë gjen se gjykatat e instancave më të ulëta kanë vendosur drejtë, dhe me të drejtë është refuzuar ankesa e paditësit, pasi që organet administrative kanë konstatuar (gjatë procedurës disiplinore) se shqiptimi i masës, ndalesa në të ardhura personale prej 10 % e pagës mujore është në përputhje me nenin 59.1 dhe 2 të Ligjit nr.03/L-149 për KPMSHCK.

Të pabazuara janë thëniet e paditësit lidhur me shkeljet sepse i vlerësoi të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë, ngase aktgjykimi i goditur është i qartë dhe i kuptueshëm, përmbanë arsye të mjaftueshme dhe faktet vendimtare për marrjen e vendimeve të ligjshme. Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se nuk është cënuar ligji në dëm të paditësit dhe është bërë aplikimi i drejt të drejtës materiale.

Nga sa u tha më lartë dhe në pajtim me nenin 54.1 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

ARJ.UZVP. nr.37/2017 dt. 25.07.2017

Procesmbajtësi,

Sherif Krasniq

Kryetari i kolegjit,

Nebojsa Boriçiq

Përktheu: Ferid Abazi